



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 567/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga Ferit Osmani kryesues, Vllastimir Dimic dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkatësi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) paraqitur kundër Musa Imeraj, Mimoza Shala dhe Ali Tahir-Sylaj, kryesues te VV 01R, 05R dhe 06R, Deçan, ne lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 15.12.2010, mori:

### VENDIM

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN)

### ARSYETIMI

Më datë 13.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN paraqitur kundër Musa Imeraj, Mimoza Shala dhe Ali Tahir-Sylaj, kryesues te VV 01R, 05R dhe 06R, Deçan, ne te cilën pretendohet se “ne QV nr. 0108C/01R ne orën 14:27 minuta te datës 12.12.2010, llampat ultravjollce nuk kane punuar, po ashtu llampat nuk kane qene funksionale edhe ne VV nr. 0108C/05R; 06R. Sipas kryesuesve te këtyre VV-ve llampat nuk kane funksionuar siç duhet, por procesi ka rrjedhur normalisht”.

Ne mbështetje te pretendimeve parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë prove materiale, me përjashtim te numrave telefonik te Floren Spahija dhe Uke Selimaj, ne rolin e dëshmitarit.

Neni 59 paragrafi 2 i LZP-së, specifikon si me poshte:

*59.2 KQZ-ja e Kosovës siguron përgatitjen dhe mbajtjen e zgjedhjeve ne pajtim me parimet dhe kërkesat e këtij ligji;*

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 6.4 (Vendimet për Ankesat) parasheh si vijon:

6.4 "Panelet mund ta refuzojnë me procedurë të shpejtë ankesën apo një grumbull ankesash, të cilat nuk janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore apo at të cilat sipas mendimit të tyre nuk paraqesin një rast *prima facie*".

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lendes gjeti se:

**-ankesa është e palejuar**

PZAP-i vlerëson se ankesa e BIRN paraqitur përkundrejt anëtarëve të VV nr. 0108C/01R; 05R dhe 06R, është jashtë juridiksionit të PZAP, për shkak se KQZ është organi i cili merret me funksionalizimin dhe organizimin e zgjedhjeve duke përfshirë edhe përdorimin e detektorëve gjate procesit të zgjedhjeve, fakt ky që konfirmohet nëpërmjet Rregullës Zgjedhore Nr. 09/2009. Prandaj për këtë arsye dhe në pajtim të dispozitave ligjore të cekura më lartë si dhe në pajtim të nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 567/2010 më datën 15.12.2010.

